

KOLEGJI "BIZNESI"

Nr. 457/20 Data: 01.12.20  
PRIZREN



KOLEGJI - COLLEGE  
**BIZNESI**  
Prishtinë



## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Neni 1

Palët nënshkruese të këtij memorandumi:

1. Kolegji BIZNESI-Prishtinë, rruga "Motrat Qiriazi" nr 29 të cilën e përfaqëson Dr. Shyqeri Kabashi -Dekan, dhe
2. SatStyro Company, Adresa: "Mushnikovë" p.n. 20530 Reqanë-Prizren R. e Kosovës, me NRB 810602294.

Neni 2

Qëllimi i këtij Memorandumi

Ky Memorandum bashkëpunimi ka për qëllim përcaktimin e fushave të bashkëpunimit, kushteve dhe afatet themelore, në bazë të të cilave Kolegji BIZNESI- Prishtinë dhe SatStyro-Prizren, pajtohen për bashkëpunim.

Neni 3

Fushat e bashkëpunimit

1. SatStyro-Prizren do të ndihmojë dhe mbështesë në vazhdimësi Kolegjin Biznesi, në pranimin e studentëve për realizimin e praktikës, dhe dhënjën e sygjërimeve për nevojat e ekonomisë së tregut si pal e interesit nga jashtë, të bazuar në politikat e këtij institucionit.
2. Kolegji Biznesi do të mbështesë në vazhdimësi SatStyro-Prizren në aspektin e trajnimeve në fushat: **menaxhimi i emergjencave** (mbrojtjes nga zjarrit duke kontrolluar dhe servisuar aparatat për shuarjen e zjarrit), **ekonomisë** (hartimin e pasqyrave financiare dhe planit të biznesit), **juridike** (hartimi i kontratave dhe rregulloreve) dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të personelit.
3. Kolegji Biznesi do të mbështesë, SatStyro-Prizren me stafin e sajë akademik, për ligjërata nga lëmia: Emergjencave, Ekonomisë dhe Jurisprudencës-sipas nevojave që paraqet SatStyro.



Neni 4  
Interpretimi dhe ndryshimi i memorandumit

1. Interpretimi i këtij Memorandumi do të bëhet në pajtim me Ligjet e Kosovës, duke e ruajtur parimin e reciprocitetit.
2. Afati i këti memorandumit është në kohë të pacaktuar. Ndryshimet dhe plotësimet e këti Memorandumi mund të bëhen vetëm me shkrim dhe të nënshkuara nga të dyja palët.

Neni 5  
Kopjet e Memorandumit


Memorandumi është punuar në katër kopje origjinale, nga dy kopje për secilën palë.

Neni 6  
Hyrja në fuqi

Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.

PALËT NËNSHKRUESE

Kolegji BIZNESI Prishtinë

  
/Prof Dr Shyqeri Kabashi/  
D e k a n



SatStyro SH.P.K.  
  
/Adil Bajrami/  
Drejtore



Nënshkruar në Prishtinë, me datë 01/12/2020

